KIRFN Interpretimi 16
Mbrojtja e një Investimi Neto në një Operacion të kryer jashtë vendit

Referenca

- SNRF 9 *Instrumentet financiare*
- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në monedhat e huaja*

Historiku

1 Shumë njësi ekonomike raportuese kanë investime në operacione të huaja (siç përcaktohen në SNK 21 paragrafi 8). Këto operacione të huaja mund të jenë filiale, pjesëmarrje të përbashkëta ose degë. SNK 21 kërkon që njësia ekonomike të përcaktojë monedhën funksionale për çdo operacion të huaj të saj si monedhë primare të mjedisit ekonomik të operacionit përkatës. Kur bëhet përkthimi i rezultateve dhe i pozicionit financiar i një operacioni të huaj në monedhën prezantuese, njësia ekonomike duhet të njohë diferenca këmbimi në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri në momentin kur ajo do të nxjerrë jashtë këtë operacion të huaj.

2 Kontabiliteti mbrojtës ndaj rrezikut nga monedhat e huaja që rrjedhin nga investimi neto në operacione të huaja do të zbatohet kur aktivet neto të atij operacioni të huaj janë përfshirë në pasqyrat financiare.[1] Elementi për të cilin bëhet mbrojtja nga rreziku i monedhës së huaj që lind nga një investim neto në një operacion të huaj mund të jetë një shumë e aktiveve neto e barabartë ose më e vogël se vlera neto e mbartur e aktiveve të këtij operacioni të huaj.

3 SNRF 9 kërkon që të përcaktohet çdo element që do mbrohet dhe çdo instrument mbulues sipas një marrëdhënie të kontabilitetit mbrojtës. Nëse ka një marrëdhënie mbrojtëse të përcaktuar, në rastin e mbrojtjes së një investimi neto, fitimi ose humbja në instrumentin mbrojtës që është përcaktuar si një mbrojtje e efektive e investimit neto, njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihet së bashku me diferencat e tjera të këmbimit që vijnë nga përkthimi i rezultatit dhe pozicionit financiar të operacionit të huaj.

4 Një njësi ekonomike me shumë operacione të huaja mund të ekspozohet përballë shumë rreziqeve nga monedhat e huaja. Ky interpretim jep udhëzime se si identifikohen rreziqet nga monedhat e huaja të cilat klasifikohen si rrezik i mbrojtur në mbrojtjen e një investimi neto në një operacion të huaj.

5 SNRF 9 lejon një njësi ekonomike të përcaktojë një instrument financiar derivativ apo jo-derivativ (ose një kombinim të tyre) si instrumente mbrojtës për një rrezik nga monedhat e huaja. Ky Interpretim jep udhëzime se ku duhen mbajtur, brenda grupit, instrumentet mbrojtës të cilët janë mbrojtje për investimet në një operacion të huaj, që të trajtohen sipas kontabilitetit mbrojtës.

6 SNK 21 dhe SNRF 9 kërkojnë që shumat e akumuluara të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje në të dyja rastet diferencat nga kurset e këmbimit si pasojë e përkthimit të rezultatit dhe pozicionit financiar të operacionit të huaj dhe fitimi ose humbja në instrumentin mbrojtës që është përcaktuar si një mbrojtje efektive të investimit neto të riklasifikohen nga elementët e kapitalit tek fitimi ose humbja, si një rregullim riklasifikimi kur njësia ekonomike mëmë shet këtë operacion të huaj. Ky Interpretim jep udhëzime se si një njësi ekonomike duhet të përcaktojë shumat që duhen kaluar nga elementët e kapitalit në fitim ose humbje për të dyja rastet instrumentin e mbrojtjes dhe elementin e mbrojtur.

Objekti

7 Ky Interpretim zbatohet në një njësi ekonomike e cila mbrohet nga rreziku i monedhave të huaja për investimet neto në një operacion të huaj dhe dëshiron të zbatojë kontabilitetin mbrojtës në përputhje me SNRF 9. Për lehtësi ky Interpretim i referohet këtyre njësive ekonomike si njësi ekonomike mëmë dhe pasqyrave financiare në të cilat përfshihen aktivet neto të operacioneve te huaja si pasqyra financiare të

[1] Ky do të jetë rasti për pasqyrat financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare në të cilat investime të tilla si pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto, dhe pasqyrat financiare që përfshijnë një degë ose një operacion të përbashkët siç është përkufizuar në SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta.*

konsoliduara. Të gjitha referencat për njësinë ekonomike mëmë janë të barasvlefshme dhe për një njësi ekonomike që ka investime neto në një sipërmarrje të përbashkët, pjesëmarrje, ose degë.

8 Ky interpretim zbatohet vetëm për mbrojtjen e investimeve neto në një operacion të huaj; ai nuk duhet zbatuar për analogji në metoda të tjera të kontabilitetit mbrojtës.

Çështjet

9 Investimet në një operacion të huaj mund të zotërohen në mënyrë direkt nga njësia ekonomike mëmë ose në mënyrë indirekte nga filiali ose filialet e saj. Çështjet e prekura nga ky Interpretim janë:

(a) *natyra e rrezikut të mbrojtur dhe shuma e elementit të mbrojtur për të cilin një marrëdhënie mbrojtje mund të përcaktohet:*

(i) nëse njësia ekonomike mëmë mund të përcaktojë si një rrezik që duhet të mbrohet vetëm diferencat e këmbimit të monedhave të huaja që rezultojnë si pasojë e diferencave midis monedhës funksionale të njësisë ekonomike mëmë dhe monedhës funksionale të operacionit të saj të huaj, ose nëse njësia ekonomike mëmë mund të përcaktojë si rrezik që duhet të mbrohet gjithashtu dhe diferencat e këmbimit që rezultojnë si diferenca midis monedhës së paraqitjes në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike mëmë dhe monedhës funksionale të operacionit të huaj;

(ii) nëqoftëse njësisë ekonomike mëmë zotëron operacionin e huaj indirekt, nëse rreziku i mbrojtur mund të përfshijë vetëm diferencat e këmbimit që rrjedhin midis monedhës funksionale të operacionit të huaj dhe të njësisë ekonomike mëmë të saj(filial) nga varet direkt, ose nëse risku i mbrojtur mund të përfshijë gjithashtu çdo lloj diference këmbimi midis monedhës funksionale të operacionit të huaj me cilëndo nga njësitë ekonomike mëmë ndërmjetëse apo të fundit (filialet) nga ku varet (që do të thotë që fakti nëse investimi neto në një operacion të huaj zotërohet nëpërmjet një (njësie ekonomike mëmë (filiali) ndërmjetëse ai ndikon në rrezikun ekonomik të njësisë ekonomike mëmë të fundit).

(b) *ku brenda grupit mund të mbahet instrumenti mbrojtës:*

(i) nëse një marrëdhënie që kualifikohet për kontabilitet mbrojtës mund të vendoset vetëm nëse njësia ekonomike që mbron investimet e saj neto është një pjesë ne instrumentet mbrojtës apo nëse çdo njësi ekonomike e grupit, pavarësisht nga monedha funksionale e saj, mund të mbajë instrumentin mbrojtës;

(ii) nëse natyra e instrumentit mbrojtës (derivativ ose jo-derivativ) apo metoda e konsolidimit ndikon vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes.

(c) *çfarë shumash duhen riklasifikuar nga elementët e kapitalit neto në fitime ose humbje si rregullime riklasifikimi në shitjen e një operacioni të huaj:*

(i) kur një operacion i huaj i cili ka qenë i mbrojtur shitet (nxirret jashtë përdorimit), çfarë shumash nga rezervat e përkthimit nga monedhave të huaja të mëmës në raport me instrumentin mbrojtës dhe në raport me këtë operacion të huaj duhen riklasifikuar nga elementët e kapitalit neto në fitim ose humbje në pasqyrat financiare të mëmës;

(ii) metoda e konsolidimit ndikon në përcaktimin e shumave që duhet të riklasifikohen nga kapitali neto në fitim ose humbje.

Konsensusi

Natyra e rrezikut të mbrojtur dhe shuma e elementit të mbrojtur për të cilin një marrëdhënie mbrojtje mund të përcaktohet

10 Kontabiliteti mbrojtës mund të zbatohet vetëm në rastin e diferencave e kurseve të këmbimit të huaja që rezultojnë midis monedhës funksionale të operacionit të huaj dhe monedhës funksionale të njësisë ekonomike mëmë.

11 Në një mbrojtje nga rreziku i monedhave të huaja që lind nga një investim neto në një operacion të huaj, elementi që mbrohet mund të jetë një shumë e aktiveve neto e barabartë me ose më e vogël se vlera neto e mbartur e aktiveve neto të këtij operacioni të huaj në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë

 © Fondacioni i SNRF-ve

ekonomike mëmë. Vlera e mbartur e aktiveve neto të një operacioni të huaj, i cili mund të përcaktohet si element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës varet nëse ndonjë nivel më i ulët i mëmës zotëruese të operacionit të huaj ka zbatuar kontabilitetin mbrojtës për të gjithë ose për një pjesë të aktiveve të këtij operacioni të huaj dhe ky kontabilitet është ruajtur në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës.

12 Si rrezik që duhet mbrojtur mund të përcaktohen dhe ekspozimet (diferencat) e monedhave të huaja që lindin midis monedhës funksionale të operacionit të huaj dhe monedhës funksionale të çdonjërës prej njësive ekonomike mëmë (njësi ekonomike mëmë direkte, e ndërmjetme apo fundore)) të këtij operacioni të huaj. Fakti që investimi neto zotërohet nëpërmjet një mëme të ndërmjetme, nuk ndikon natyrën e rrezikut ekonomik që lind nga ekspozimi ndaj monedhave të huaja i njësisë ekonomike mëmë të fundit.

13 Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhave të huaja që lindin nga një investim neto në një operacion të huaj, mund të kualifikohet për kontabiliteti mbrojtës vetëm pasi është paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara. Kështu që nëse i njëjti aktiv neto në një operacion të huaj mbrohet nga më shumë se një njësi ekonomike mëmë brenda grupit (p.sh. nga të dyja si nga njësia ekonomike mëmë direkte ose indirekte)) për të njëjtin rrezik, vetëm një marrëdhënie mbrojtje do të kualifikohet për t'u trajtuar për kontabilitet mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike mëmë të fundit. Një marrëdhënie mbrojtëse e përcaktuar nga njëra prej njësive ekonomike mëmë në pasqyrat e saja financiare të konsoliduara, nuk ka nevojë të trajtohet përsëri dhe në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike mëmë të nivelit të mësipërm. Sidoqoftë nëse nuk është trajtuar si e tillë nga njësia ekonomike mëmë e nivelit më të lartë, kontabiliteti mbrojtës i zbatuar nga njësia ekonomike mëmë e nivelit më të ulët duhet të anullohet para se njësia ekonomike mëmë e nivelit më të lartë të njohë kontabilitetin mbrojtës.

Vendi se ku mund të mbahet brenda grupit instrumenti mbrojtës

14 Një instrument derivativ apo jo-derivativ (ose një kombinim i tyre) mund të përcaktohet si instrument mbulues i një investimi neto në një njësi ekonomike të huaj. Instrumenti ose instrumentet mbulues mund të mbahen nga çdonjëra prej njësive ekonomike brenda grupit për aq kohë sa plotësohen kërkesat e përcaktimit, dokumentacionit dhe efektivitetit sipas SNRF 9 paragrafi 6.4.1 që i përkasin mbrojtjes së një investimi neto. Në veçanti strategjia mbrojtëse e grupit duhet dokumentuar qartë për shkak të përcaktimeve të ndryshme në nivele të ndryshme brenda grupit.

15 Për qëllimet e vlerësimit të efektivitetit, ndryshimi në vlerën e instrumentit mbrojtës për rrezikun nga monedhat e huaja llogaritet duke i'u referuar monedhës funksionale të njësisë ekonomike mëmë, kundrejt asaj monedhe funksionale që rreziku është matur, në përputhje me dokumentacionin e kontabilitetit mbrojtës. Në varësi se ku mbahet instrumenti mbrojtës, në mungesë të një kontabiliteti mbrojtës totali i ndryshimit të vlerës mund të njihet në fitim ose humbje, në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse ose në të dyja. Megjithatë vlerësimi i efektivitetit nuk ndikohet nëse ndryshimi në vlerë i instrumentit mbrojtës është njohur në fitim humbje apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Si pjesë e aplikimit të kontabilitetit mbrojtës, totali i ndryshimit përfshihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Vlerësimi i efektivitetit nuk ndikohet nëse instrumenti mbrojtës është derivativ apo jo-derivativ, apo nga metoda e konsolidimit.

Nxjerrja jashtë përdorimit e një operacioni të huaj të mbrojtur

16 Kur një operacion i kryer jashtë vendit i cili ka qenë i mbrojtur nxirret jashtë përdorimit, shuma që riklasifikohet për në fitim ose humbje, si rregullim riklasifikimi nga rezervat e përkthimit të monedhave të huaja që lidhen me instrumentin mbrojtës, në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë është shuma që përcaktohet sipas kërkesave të SNRF 9 paragrafi 6.5.14. Kjo shumë është fitimi ose humbja e akumuluar për instrumentin mbulues që ishte përcaktuar si një mbrojtje efektive.

17 Shuma e riklasifikuar në fitim ose humbje nga rezervat e përkthimit të monedhave të huaja në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës që i përkasin investimit neto në një operacion të huaj në përputhje me SNK 21 paragrafi 48, është shuma e përfshirë në rezervat e përkthimit të monedhave të huaja të mëmës që lidhen me këtë operacioni të huaj. Në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës së fundit, shuma totale neto e njohur në rezervat e përkthimit të monedhave të huaja, që i përkasin të gjitha operacioneve të huaja nuk ndikohet nga metoda e konsolidimit. Megjithatë, fakti nëse mëma e fundit përdor metodën e konsolidimit direkte apo hap-pas-hapi[2]mund të ndikojë në shumën e përfshirë në rezervat e saj të përkthimit të monedhave të huaja për një operacion të huaj individual. Përdorimi i metodës së konsolidimit hap-pas-hapi mund të rezultojë në ri klasifikimin në fitim ose humbje të një shumë të ndryshme nga ajo që përdoret

[2] Metoda direkte e konsolidimit është metoda në të cilën pasqyrat financiare të operacionit të huaj përkthehen në mënyrë direkte në monedhën funksionale të mëmës përfundimtare. Metoda hap-pas-hapi është metoda e konsolidimit në të cilën pasqyrat financiare të operacionit të huaj përkthehen fillimisht në monedhën funksionale të mëmës ndërmjetëse dhe pastaj përkthehen në monedhën funksionale të mëmës përfundimtare (ose në monedhën raportuese nëse është e ndryshme).

për të përcaktuar efektivitetin e mbrojtjes. Kjo diference mund të eliminohet duke përcaktuar shumën që i përket këtij operacioni të huaj e cila do të rezultonte nëse do të ishte përdorur metoda direkte e konsolidimit. Bërja e një rregullimi të tillë nuk kërkohet nga SNK 21. Megjithatë, është një zgjedhje në politikat kontabël që duhet ndjekur në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha investimet neto.

Data e hyrjes në fuqi

18 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim për periudhat vjetore që fillojnë ne datë 1 tetor 2008 ose me vonë. Një njësi ekonomike duhet të aplikojë ndryshimet me paragrafin 14 të kryera nga *Përmirësimet e SNRF-ve* të publikuara në prill 2009 për periudha që fillojnë më ose pas 1 korrik 2009. Zbatimi për periudha më të hershme është i lejueshëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë Interpretim për periudha që fillojnë përpara datës 1 tetor 2008, ose ndryshimin në paragrafin 14 para datës 1 korrik 2009, ky fakt duhet sqaruar në shpjegimet shpjeguese.

18A [Fshirë]

18B SNRF 9 i publikuar në korrik 2014, ka ndryshuar paragrafët 3, 5-7, 14, 16, UZ1 dhe UZ8 dhe ka fshirë paragrafin 18A. Njësia ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 9.

Periudha kalimtare

19 SNK 8 specifikon se si një njësi ekonomike zbaton një ndryshim në politikat kontabël që rrjedh nga zbatimi i një Interpretimi. Një njësi ekonomike nuk kërkohet që të plotësojë këto kërkesa kur zbaton për herë të parë Interpretimin. Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një instrument mbrojtës si mbrojtje për një investim neto, por mbrojtja nuk plotëson kushtet për një kontabilitet mbrojtës në këtë Interpretim, atëherë njësia ekonomike do të aplikojë SNK 39 dhe të ndërpresë trajtimin kontabël mbrojtës në mënyrë prospektive.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojcë Udhëzim zbatimi

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e këtij Interpretimi.

UZ1 Kjo shtojcë ilustron zbatimin e Interpretimit duke përdorur një strukturë kompanie sipas ilustrimit të mëposhtëm. Në të gjitha rastet marrëdhënia e mbrojtjes e përshkruar duhet të testohet për efektivitetin në përputhje me SNRF 9, megjithëse ky testim nuk përmendet në këtë udhëzim. Mëma, duke qenë njësia ekonomike mëmë përfundimtare, përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara të saj në monedhën funksionale të saj që është euro (EUR). Çdo filial zotërohet tërësisht prej saj. Mëma ka investuar 500 milion paund (sterlina angleze) në një investim neto në filialin e saj B (që ka si monedhë funksionale paundin (GBP)). Ky investim përfshin një investim prej 159 milion paund (ekuivalentë 300 milion dollarë amerikanë) të filialit B në filialin C (që ka monedhë funksionale dollarin amerikan (USD)). Me fjalë të tjera, aktivet neto të filialit B pa përfshirë investimin neto në filialin C janë 341 milion GBP.

Natyra e rrezikut të mbrojtur për të cilin mund të përcaktohet një marrëdhënie mbrojtje (paragrafët 10-13)

UZ2 Mëma mund të mbrojë investimin e saj neto në secilën prej filialeve A, B, dhe C prej rrezikut nga këmbimi i monedhave të huaja midis monedhave të tyre funksionale respektive (Jeni Japonez (JPY), Paundit Anglez (GBP), dhe Dollari Amerikan (USD) dhe Euros. Për më tepër, Mëma mund të mbrojë rrezikun nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja USD/GBP me monedhat funksionale të Filialit B dhe të Filialit C. Në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara Filiali B mund të mbrojë investimin e tij neto në Filialin C për rrezikun nga këmbimi i monedhave të huaja midis monedhave të tyre funksionale të USD dhe sterlina angleze (GBP). Në shembullin e mëposhtëm rreziku i përcaktuar është rreziku momental i këmbimit të monedhave të huaja sepse instrumentet e mbrojtjes nuk janë derivativë. Nëqoftëse instrumentet e mbrojtjes



do të ishin kontrata të ardhshme, Mëma mund të përcaktonte rrezikun e kursit të ardhshëm të këmbimit të monedhave të huaja.

Shuma e elementit të mbrojtur për të cilin një marrëdhënie mbrojtje mund të përcaktohet (paragrafët 10-13)

UZ3 Mëma dëshiron të mbrohet prej rrezikut të kursit të këmbimit të monedhës së huaj në investimin e saj neto në Filialin C. Le të supozohet që Filiali A ka një huamarrje të jashtme prej 300 milion USD. Aktivet neto të Filialit A në fillim të periudhës raportuese janë 400,000 milion ¥ që përfshijnë shumat huamarrjes së jashtme prej 300 milion USD.

UZ4 Elementi i mbrojtur mund të jetë një shumë e aktiveve neto e barabartë ose më e vogël se shuma e mbartur investimeve neto të Mëmës në Filialin C (300 milion USD) si paraqitet në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara. Në pasqyrat financiare të konsoliduara të saja Mëma mund të përcaktojë shumën 300 milion USD të marrë hua të jashtme në Filialin A si një mbrojtje për rrezikun e kursit momental të këmbimit EUR / USD që lidhet me investimin e saj neto prej 300 milion USD në Filialin C. Në këtë rast të dyja, diferencat e këmbimit EUR / USD të llogaritura mbi 300 milion USD hua e jashtme në Filialin A dhe diferenca e

këmbimit të EUR/USD të llogaritura mbi 300 milion USD investim neto në Filialin C, janë përfshirë në rezervat e përkthimit të monedhave të huaja në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës pas aplikimit të kontabilitetit të mbrojtjes.

UZ5 Në mungesë të kontabilitetit të mbrojtjes, totali i diferencave të këmbimit USD/EUR të llogaritura mbi 300 milion USD hua e jashtme në Filialin A do ishte njohur në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës si më poshtë:

- ndryshimi i kursit të këmbimit i momentit midis USD / JPY, i përkthyer në EUR, njihet në fitim ose humbje, dhe
- ndryshimi i kursit të këmbimit i momentit midis JPY / EUR, njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Në vend të përcaktimit të bërë në paragrafin UZ4, Mëma në pasqyrat e veta financiare të konsoliduara mund të përcaktojë huan e jashtme prej 300 milion USD në Filialin A si një mbrojtje për rrezikun e kursit momental të këmbimit GBP/USD midis Filialit C dhe Filialit B. Në këtë rast, totali i diferencave të këmbimit USD/EUR i llogaritur mbi 300 milion USD hua e jashtme në Filialin A do ishte njohur në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës si më poshtë:

- ndryshimi i kursit të këmbimit të momentit midis GBP / USD, njihet si rezerva të përkthimit te monedhave të huaja që i përkasin Filialit C,
- ndryshimi i kursit të këmbimit i momentit midis GBP / JPY, i përkthyer në euro, njihet në fitim ose humbje, dhe
- ndryshimi i kursit të këmbimit i momentit midis JPY / EUR, njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

UZ6 Mëma nuk mund të përcaktojë prej 300 milion USD të marrë si hua e jashtme në Filialin A si një mbrojtje për të dy rreziqet: rrezikun e ndryshimit të kursit momental të këmbimit EUR/USD dhe rrezikun e ndryshimit të kursit momental të këmbimit të GBP/USD në pasqyrat financiare të konsoliduara të saja. Një instrument mbrojtës i veçantë mund të mbrojë të njëjtin rrezik vetëm njëherë. Filiali B nuk mund të zbatojë kontabilitetin mbrojtës në pasqyrat e tij financiare të konsoliduara, sepse instrumenti mbrojtës zotërohet jashtë grupit të përbërë nga Filiali B dhe Filiali C.

Vendi se ku mund të mbahet brenda grupit instrumenti mbrojtës(paragrafët 14 dhe 15)?

UZ7 Siç thuhet dhe në paragrafin UZ5, totali i ndryshimit të vlerave për shkak të rrezikut të kursit të këmbimit për huan e jashtme prej 300 milion USD në Filialin A, në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës në rast së nuk do ishte aplikuar kontabiliteti mbrojtës do të regjistrohej si në fitimet dhe humbjet (rreziku i këmbimit momental i USD/JPY) ashtu dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (rreziku i këmbimit momental i EUR / JPY). Të dyja shumat janë përfshirë për qëllim të matjes së efektivitetit të mbrojtjes sipas paragrafit UZ4 sepse ndryshimi i vlerave si për instrumentin mbrojtës ashtu dhe për elementin e mbrojtur është llogaritur duke i'u referuar monedhës funksionale EURO të Mëmës përkundrejt monedhës funksionale USD të Filialit C, në përputhje me dokumentacionin mbrojtës. Metoda e konsolidimit (d.m.th metoda direkte apo hap-pas-hapi) nuk ndikon në vlerësimin e efektivitetit të mbrojtjes.

Shumat e riklasifikuara në fitim humbje për nxjerrjen jashtë përdorimit të një operacioni të huaj (paragrafët 16 dhe 17)

UZ8 Kur Filiali C nxirret jashtë përdorimit, shumat e riklasifikuara nga rezervat e saj të përkthimit të monedhave të huaja (RPMH) për në fitime ose humbje në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmës janë:

(a) në lidhje me hua marrjen e jashtme 300 milion USD në Filialin A, është shuma që SNRF 9 kërkon të identifikohet, d.m.th ndryshimi total në vlerë që i përket rrezikut të këmbimit të monedhave të huaja i cili është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse si pjesa përkatëse e mbrojtjes; dhe

(b) në lidhje me investimin neto në Filialin C prej 300 milion USD, shuma përcaktohet sipas metodës së konsolidimit të Filialit. Nëqoftëse Mëma përdor metodën direkte, rezerva e saj rrezikut të përkthimit të monedhave të huaja (RPMH) në lidhje me Filialin C do përcaktohet direkt nga kursi i këmbimit EUR/USD. Nëqoftëse Mëma përdor metodën hap-pas-hapi, rezerva e saj e rrezikut të përkthimit të monedhave te huaja (RPMH) në lidhje me Filialin C do përcaktohet nga RPMH e njohur nga Filiali B që reflekton kursin e këmbimit të GBP/USD, përkthyer në monedhën funksionale të Mëmës duke përdorur kursin e këmbimit EUR/GBP. Përdorimi i metodës hap-pas-

 © Fondacioni i SNRF-ve

hapi nga Mëma në periudhat e mëparshme nuk i kërkon asaj ose të ndalojë atë që të përcaktojë shumën e rezervës për përkthimin e monedhave të huaja (RPMH) që duhet riklasifikuar kur ajo nxjerr jashtë përdorimit Filialin C, si një shumë e cila mund të ishte llogaritur sikur ajo të kishte përdorur gjithnjë metodën direkte, kjo në varësi të politikave të saj kontabël.

Mbrojtja e më shumë sesa një operacioni të huaj (paragrafët 11, 13 dhe 15)

UZ9 Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë që në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës, rreziku që mund të mbrohet është gjithmonë rreziku midis monedhës funksionale (EUR) dhe monedhave funksionale të Filialeve B dhe C. Pavarësisht se si janë përcaktuar mbulimet, maksimumi i shumave efektive të mbrojtjes që mund të jenë mbrojtje efektive për t'u përfshirë në rezervën e përkthimit të monedhave të huaja në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës kur të dy operacionet e huaja janë mbrojtur, janë 300 milion USD për rrezikun e këmbimit EUR/USD dhe 341 milion GBP për rrezikun EUR/GBP. Ndryshimet e tjera të vlerave për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit të monedhave të huaja janë përfshirë në fitimet ose humbjet e konsoliduara të Mëmës. Natyrisht që mund të ishte e mundur për Mëmën të përcaktonte 300 milion USD vetëm për ndryshimin e kursit të këmbimit momental të USD / GBP ose 500 milion vetëm për ndryshimin e kursit të këmbimit të momentit të GBP / EUR.

Mëma mban instrumentet mbrojtës për të dyja USD dhe GBP

UZ10 Mëma mund të dëshirojë të mbrojë rrezikun e këmbimit të monedhave të huaja si në lidhje me investimin neto në Filialin B ashtu dhe me investimin neto në Filialin C. Le të supozohet se Mëma ka instrumente mbrojtje të përshtatshëm në USD dhe GBP të cilët mund t'i përcaktojë si mbrojtje të investimeve neto të saj në Filialin B dhe C. Përcaktimet që Mëma mund të bëjë në pasqyrat e saja të konsoliduara përfshijnë, por nuk kufizohen, sa më poshtë:

(a) Instrumenti mbrojtës prej 300 milion USD i përcaktuar si një mbrojtje për investimin neto 300 milion USD në Filialin C me rrezikun që të ketë një ekspozim i kursit të këmbimit të monedhave të huaja (EUR/USD) midis Mëmës dhe Filialit C dhe deri në 341 milion GBP si instrument mbrojtës i përcaktuar për mbrojtjen e 341 milion GBP të investimit neto në Filialin B me rrezikun që të ketë një ekspozim nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja (EUR/GBP) midis Mëmës dhe Filialit B.

(b) Instrumenti mbrojtës prej 300 milion USD i përcaktuar si një mbrojtje për investimin neto 300 milion USD në Filialin C me rrezikun që të ketë një ekspozim i kursit të këmbimit të monedhave të huaja (GBP/USD) midis Filialit B dhe Filialit C dhe deri në 500 milion GBP si instrument mbrojtës i përcaktuar për mbrojtjen e 500 milion GBP të investimit neto në Filialin B me rrezikun që të ketë një ekspozim nga kursi i këmbimit të monedhave të huaja (EUR/GBP) midis Mëmës dhe Filialit B.

UZ11 Rreziku EUR/USD për investimin neto të Mëmës në Filialin C është i ndryshëm nga rreziku EUR/GBP i Mëmës në investimin neto në Filialin B. Sidoqoftë, në rastin e përshkruar në UZ10(a), Mëma, duke përcaktuar instrumentin mbrojtës USD që ajo zotëron, ka mbrojtur gjithashtu plotësisht rrezikun EUR/USD për investimin neto të saj në Filialin C. Në qoftë se Mëma do kishte përcaktuar gjithashtu një instrument GBP si një mbrojtje të investimit neto të saj prej 500 milion GBP në Filialin B, 159 milion GBP në këtë investim neto, që përfaqëson në GBP investimin e saj neto në USD në Filialin C do ishte mbrojtur dy herë për rrezikun e këmbimit GBP/EUR në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës.

UZ12 Në rastin e përshkruar në paragrafin UZ10(b) në qoftë se Mëma përcakton si rrezik për t'u mbrojtur rrezikun e ekspozimit të kursit të këmbimit të momentit (GBP/USD) midis Filialeve B dhe C, vetëm pjesa e GBP/USD e ndryshimit në vlerën e saj të instrumentit mbrojtës 300 milion USD do të përfshihet në rezervat e përkthimit të monedhave të Mëmës në lidhje me Filialin C. Pjesa e mbetur e ndryshimit (ekuivalent me ndryshimin për kursin GBP/EUR të 159 milion GBP) do përfshihet në fitime ose humbje të konsoliduara të Mëmës, sipas paragrafit UZ5. Për shkak se përcaktimi i rrezikut të USD/GBP midis Filialeve B dhe C nuk përfshin rrezikun GBP/EUR, Mëma mundet gjithashtu që të përcaktojë deri në 500 milion GBP të investimit të saj neto në Filialin B me rrezikun për të qenë i ekspozuar për kursin e këmbimit të momentit (GBP/EUR) midis Mëmës dhe Filialit B.

Filiali B zotëron instrument mbrojtës USD

UZ13 Le të supozohet se Filiali B zotëron 300 milion USD borxh të jashtëm shuma e të cilit i është transferuar Mëmës si një hua brenda grupit e shprehur në monedhën GBP. Për shkak se si aktivet ashtu edhe detyrimet e tij janë rritur me 159 milion GBP, aktivet neto të Filialit B nuk kanë ndryshuar. Filiali B mund të

përcaktojë borxhin e jashtëm si mbrojtje për rrezikun e këmbimit GBP/USD të investimit të tij neto në Filialin C, në pasqyrat financiare të konsoliduara të tij. Mëma mund të ruajë përcaktimin e Filialit B të këtij instrumenti mbrojtës si një mbrojtje të investimit të saj neto 300 milion USD në Filialin C për rrezikun GBP/USD (shiko paragrafin 13) dhe Mëma mund të përcaktojë instrumentin mbrojtës GBP që zotëron si një mbrojtje për të gjithë investimin e saj 500 milion GBP në filialin B. Mbrojtja e parë, e përcaktuar nga Filiali B, do të vlerësohej në lidhje me monedhën funksionale të Filialit B (sterlina angleze GBP) dhe mbrojtja e dytë, e përcaktuar nga Mëma do të vlerësohej duke ju referuar monedhës funksionale të Mëmës (EUR). Në këtë rast vetëm rreziku GBP/USD prej investimit neto të Mëmës në Filialin C është mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës nga instrumenti mbrojtës USD, por jo i tërë rreziku EUR/USD. Prandaj, i tërë rreziku EUR/GBP për investimin neto të Mëmës 500 milion GBP në Filialin B mund të mbrohet në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës.

UZ14 Megjithatë, duhet të merret ne konsideratë kontabilizimi i huas prej 159 milion GBP që Mëma ka ndaj Filialit B. Në qoftë se huaja nuk është konsideruar si pjesë e investimit të saj neto në Filialin B sepse nuk plotëson kushtet në SNK 21 paragrafi 15, rreziku i diferencave të këmbimit GBP/EUR që mund të rezultojnë nga përkthimi duhet të përfshihet në të ardhurat ose humbjet e konsoliduara të Mëmës. Nëse huaja 159 milion GBP është konsideruar si pjesë e investimit neto të Mëmës, ky investim neto bëhet 341 milion GBP dhe shuma që Mëma mund të përcaktojë si një element mbrojtje për rrezikun GBP/EUR ulet për këtë arsye nga 500 milion në 341 milion GBP.

UZ15 Nëse Mëma anulon marrëveshjen e mbrojtjes së përcaktuar nga Filiali B, Mëma mund të përcaktoje 300 milion USD të borxhit të jashtëm të zotëruar nga Filiali B si një mbrojtje të investimit neto të saj 300 milion USD në Filialin C për riskun e këmbimit EUR/USD dhe të përcaktojë GBP si instrument mbrojtës ajo zotëron vetë si një mbrojtje vetëm deri në 341 milion GBP për investimin neto në Filialin B. Në këtë rast efektiviteti i të dy mbrojtjeve mund të llogaritet në monedhën funksionale të Mëmës (EUR). Si pasojë, të dy ndryshimet në vlerë të USD/GBP për borxhin e jashtëm të zotëruar nga Filiali B dhe ndryshimi në vlerë GBP/EUR për huan e Mëmës nga Filiali B (ekuivalent në USD/EUR në total), mund të përfshihen në rezervat e përkthimit të monedhave të huaja në pasqyrat financiare të konsoliduara të Mëmës. Për shkak se Mëma pothuajse ka mbrojtur tërësisht rrezikun EUR/USD të investimit neto të saj në Filialin C, ajo mund të mbrojë vetëm deri në 341 milion GBP për rrezikun EUR/GBP të investimit neto të saj në Filialin B.

 © Fondacioni i SNRF-ve